



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.115

24 gusht

2010

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.10 301 datë 15.7.2010	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8677, datë 2.11.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, të ndryshuar	5761
Vendim i KM nr.609, datë 8.7.2010	Për disa ndryshime në vendimin nr.607, datë 11.6.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë të administratës gjyqësore të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit, dhe të punonjësve me arsim të lartë të administratës së prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë dhe pranë gjykatave të apelit”	5771
Vendim i KM nr.610, datë 8.7.2010	Për disa ndryshime në vendimin nr.475, datë 13.7.2007, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratës së Presidentit, Kuvendit dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”, të ndryshuar	5772
Vendim i KM nr.611, datë 8.7.2010	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.881, datë 20.12.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve për funksionet drejtuese dhe për strukturën nivelet e pagave në Ministrinë e Punëve të Jashtme”, të ndryshuar	5775
Vendim i KM nr.612, datë 8.7.2010	Për një ndryshim në vendimin nr.561, datë 16.8.2006 të Këshillit të Ministrave “Për pagat sipas gradave për punonjësit, oficerë dhe nënoficerë, të Gardës së Republikës së Shqipërisë”	5776

Vendim i KM
nr.613, datë 8.7.2010

Për disa ndryshime në vendimin nr.371, datë 14.6.2006 të
Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të
niveleve të pagave të nëpunësve të disa institucioneve në
varësi të Këshillit të Ministrave/Kryeministrit”, të
ndryshuar..... 5777

Vendim i KM
nr.614, datë 8.7.2010

Për disa ndryshime në vendimin nr.370, datë 14.6.2006 të
Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të
niveleve të pagave të nëpunësve të administratës së
prefektit”, të ndryshuar 5780

LIGJ
Nr.10 301, datë 15.7.2010

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 8677, DATË 2.11.2000 “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E POLICISË GJYQËSORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8677, datë 2.11.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Neni 2 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 2

Parimet e funksionimit të Policisë Gjyqësore

1. Respektimi i ligjit, ruajtja dhe mbrojtja e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, profesionalizmi dhe ndershmëria janë bazat e organizimit dhe funksionimit të Policisë Gjyqësore, në funksion të përmbushjes së misionit për luftën kundër kriminalitetit dhe parandalimit të tij.

2. Policia Gjyqësore kryen veprimtari procedurale përgjatë të gjitha fazave të procedimit penal, të urdhëruar apo deleguar nga organi procedues ose me nismën e vet, sipas rregullave të legjislacionit procedural në fuqi.

3. Marrëdhëniet e bashkëpunimit midis Policisë Gjyqësore dhe prokurorisë bazohen në zbatimin e detyrave funksionale, sipas rolit dhe përgjegjësisë të ndara dhe të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.”.

Neni 2

Neni 3 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 3

Funksionet e Policisë Gjyqësore

1. Policia Gjyqësore, me cilësinë e subjektit të procedimit penal, kryen këto funksione:

- a) merr dijani për veprat penale;
- b) parandalon ose pengon pasojat e mëtejshme që rrjedhin nga veprat penale;
- c) kërkon autorët e veprave penale;
- ç) kryen veprimet e nevojshme për të siguruar burimet e provës dhe për të grumbulluar gjithçka që i shërben zbatimit të ligjit penal;
- d) kryen çdo hetim dhe veprim të urdhëruar ose të deleguar nga organi procedues;
- dh) kryen veprime procedurale për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale;
- e) kryen veprime në kuadër të marrëdhënieve juridiksionale penale me autoritetet e huaja brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;

- ë) kryen veprimet në zbatim të ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”;
- f) kryen çdo detyrë të tjetër të parashikuar në legjislacionin në fuqi.
2. Funkcionet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni ushtrohen nga oficerët dhe agjentët e Policisë Gjyqësore.
3. Policia Gjyqësore dokumenton kryerjen e funksioneve të saj në përputhje me rregullat e Kodit të Procedurës Penale.”.

Neni 3

Neni 4 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 4

Varësia e Policisë Gjyqësore

1. Policia Gjyqësore i ushtron funksionet e saj nën varësinë e prokurorit dhe drejtohet e kontrollohet prej tij.
2. Policia Gjyqësore zbaton urdhrat dhe udhëzimet e prokurorit për përcaktimin e çështjeve që duhen hetuar me përparësi, veprimeve konkrete që duhen kryer, si dhe kohëzgjatjen e nevojshme të hetimeve.
3. Prokuroritë dhe gjykatat disponojnë drejtpërsëdrejti personelin e seksioneve dhe mund të shfrytëzojnë çdo shërbim të Policisë Gjyqësore.”.

Neni 4

Neni 5 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 5

Ushtrimi i funksioneve të Policisë Gjyqësore

1. Funksionet e Policisë Gjyqësore kryhen nga oficerët dhe agjentët e Policisë Gjyqësore.
2. Pavarësisht parashikimeve të tjera me ligj të veçantë, janë oficerë të Policisë Gjyqësore punonjësit e Policisë së Shtetit të nivelit drejtues të parë, të nivelit të mesëm, si dhe të nivelit zbatues me gradën kryeinspektor.
3. Pavarësisht parashikimeve të tjera me ligj të veçantë, janë agjentë të Policisë Gjyqësore punonjësit e Policisë së Shtetit të nivelit zbatues me gradë më të ulët se kryeinspektor.
4. Oficerë dhe agjentë të Policisë Gjyqësore janë edhe punonjësit e shërbimeve të tjera policore, të cilëve me ligj u njihet kjo cilësi, si dhe personat që, me ligj, u njihen funksionet e Policisë Gjyqësore. Këta të fundit ushtrojnë funksionin e Policisë Gjyqësore në caqet e shërbimit që u është besuar dhe sipas attributeve të dhëna me ligj.”.

Neni 5

Pas nenit 5 shtohen nenet 5/a dhe 5/b me këtë përmbajtje:

“Neni 5/a

Përmbushja e funksioneve të Policisë Gjyqësore

- Oficeri dhe agjenti i Policisë Gjyqësore janë të detyruar të përmbushin funksionet e tyre, që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi, pavarësisht:
- a) nëse nuk shërbejnë në një shërbim të caktuar të Policisë Gjyqësore;
 - b) nga territori dhe rrethanat ku ndodhen;
 - c) nëse gjenden jashtë kohës së kryerjes së shërbimit.”.

“Neni 5/b
Ndalimi i publikimit të aktit

Policia Gjyqësore zbaton rregullat e legjislacionit në fuqi për ndalimin e publikimit të akteve që dokumentojnë veprimet procedurale, si dhe çdo informacioni tjetër që rrjedh prej tyre.”.

Neni 6

Në nenin 6 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 2, pas fjalës “oficeri” shtohen fjalët “i Policisë Gjyqësore, me detyrën e nivelit drejtues më të lartë”.

2. Në pikën 3 fjalët “oficeri drejtues i këtij shërbimi” zëvendësohen me fjalët “oficeri i Policisë Gjyqësore i nivelit drejtues më të lartë për shërbimin”.

3. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Në të gjitha rastet e tjera, oficeri i Policisë Gjyqësore i nivelit drejtues më të lartë për shërbimin përgjigjet përpara drejtuesit të prokurorisë, në kompetencën territoriale të të cilit ndodhet qendra e shërbimit të Policisë Gjyqësore.”.

4. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Oficeri i Policisë Gjyqësore i nivelit drejtues më të lartë për shërbimin, i paraqet drejtuesit të prokurorisë kompetente listën e emrave, nivelin dhe gradën përkatëse të punonjësve që bëjnë pjesë në shërbimet e Policisë Gjyqësore. Kjo listë përditësohet në raste të transferimeve, ngritjeve në detyrë a largimeve nga detyra të punonjësve brenda 10 ditëve. Lista i dërgohet drejtuesit të prokurorisë kompetente brenda 5 ditëve nga përditësimi i saj.”.

Neni 7

Neni 7 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 7
Organizimi i shërbimeve të Policisë Gjyqësore

1. Shërbimet e Policisë Gjyqësore ruajnë organizimin dhe hierarkinë, sipas strukturës së institucionit publik ku bëjnë pjesë.

2. Drejtuesi i institucionit, punonjësve të të cilit ligji u njeh cilësinë e oficerit ose të agjentit të Policisë Gjyqësore, është përgjegjës dhe kujdeset për ngritjen e shërbimit të Policisë Gjyqësore pranë çdo vendndodhjeje, ku kanë qendrën zyrat përkatëse të prokurorisë, si dhe për plotësimin me përbërjen dhe numrin organik të nevojshëm për përmbushjen e funksioneve të tyre.

3. Drejtuesi i institucionit, në rastet dhe mënyrat e parashikuara me ligj, si dhe në varësi të organizimit të pushtetit gjyqësor dhe të prokurorisë për ndjekjen e formave të veçanta të kriminalitetit, përgjigjet dhe kujdeset për ngritjen dhe funksionimin e shërbimeve të posaçme të Policisë Gjyqësore.”.

Neni 8

Në nenin 8 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 2 fjalët “si dhe nga juristë” zëvendësohen me fjalët “nga juristë dhe specialistë të fushave të ndryshme të ekspertizës”.

2. Pika 3 shfuqizohet.

3. Pika 6 ndryshohet si më poshtë:

“6. Prokurori i Përgjithshëm, në bashkërendim me Ministrin e Brendshëm, Ministrin e Drejtësisë dhe ministrat që kanë në kompetencë forca policore, që ushtrojnë funksione të Policisë Gjyqësore, çdo dy vjet, bazuar në kriteret e pikës 5 të këtij neni, me urdhër të përbashkët përcaktojnë:

- a) organikën për çdo seksion të Policisë Gjyqësore;
 - b) raportin e punonjësve të caktuar nga Prokurori i Përgjithshëm me punonjësit e forcave policore;
 - c) përbërjen policore;
 - ç) numrin përkatës të personelit që duhet të caktohet nga secila forcë policore.”.
4. Pas pikës 7 shtohet pika 8 me këtë përmbajtje:
“8. Pjesëtarët e seksioneve të Policisë Gjyqësore nuk mund të hiqen nga veprimtaria e Policisë Gjyqësore veçse me pëlqimin e Prokurorit të Përgjithshëm. Ata nuk mund të zëvendësohen apo hiqen nga hetimet konkrete që u janë ngarkuar, pavarësisht çastit procedural, në të cilin ky hetim ndodhet, përveçse me vendim të drejtuesit të prokurorisë.”.

Neni 9

Pas nenit 8 shtohet neni 8/a me këtë përmbajtje:

“Neni 8/a

Kryerja e veprimeve procedurale

1. Shërbimi i Policisë Gjyqësore përfundon veprimet procedurale në rastet e procedimeve penale të filluara në bazë të referimit nga vetë shërbimi i Policisë Gjyqësore. Prokurori mund të urdhërojë shërbimin e Policisë Gjyqësore për kryerjen e veprimeve të mëtejshme procedurale edhe në rastet kur njoftimi/referimi i veprës penale kryhet nga burime të tjera të ndryshme nga shërbimet e Policisë Gjyqësore.

2. Nëse prokurori çmon se veprimet procedurale duhet të vazhdoen dhe përfundohen nga ai vetë ose nga seksioni i Policisë Gjyqësore, atëherë ai njofton drejtuesin e shërbimit të Policisë Gjyqësore që ka referuar veprën penale dhe kërkon t'i dërgohen menjëherë aktet, nëse ato janë të shërbimi i Policisë Gjyqësore. Prokurori informon me shkrim shërbimin e Policisë Gjyqësore për mënyrën e përfundimit të procedimit penal të referuar.

3. Seksioni i Policisë Gjyqësore përfundon veprimet procedurale në rastet e procedimeve penale të filluara nga prokurori kryesisht apo me kallëzim të paraqitur në prokurori. Prokurori, në varësi të natyrës dhe kompleksitetit të çështjes, mund të urdhërojë kryerjen e veprimeve të mëtejshme procedurale nga shërbimet e Policisë Gjyqësore ose nga grupet hetimore të përbashkëta të shërbimeve të Policisë Gjyqësore dhe seksioneve të Policisë Gjyqësore. Rregulla më të detajuara përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrisë të Brendshme, pasi është marrë mendimi i ministrave, që kanë në varësi shërbim të Policisë Gjyqësore.

4. Drejtuesi i shërbimeve të Policisë Gjyqësore informon prokurorin për problematikën e konstatuar gjatë kryerjes së veprimtarisë procedurale.”.

Neni 10

Në nenin 9 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

- 1. Në pikën 1 fjala “titullarit” zëvendësohet me fjalën “drejtuesit”.
- 2. Në pikën 2 fjalët “i një shkalle më të lartë” zëvendësohen me fjalët “më i lartë”.
- 3. Në pikën 3 fjalët “a kualifikim” hiqen.

Neni 11

Neni 10 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 10

Kushte për caktimin

1. Oficer në seksionet e Policisë Gjyqësore mund të caktohet shtetasi që plotëson kushtet e mëposhtme:

- a) të ketë përfunduar program studimi të ciklit të dytë, në rast se është i emëruar nga Prokurori i Përgjithshëm, ose të plotësojë kriterin e arsimit, sipas ligjit të institucionit ku bën pjesë;
- b) të ketë, të paktën, 4 vjet përvojë në profesion;
- c) të mos ketë masë disiplinore apo të mos ketë filluar ndaj tij ecuria disiplinore;
- ç) të mos jetë i dënuar me një vendim penal të formës së prerë apo të mos ketë filluar ndaj tij një procedim penal;
- d) të ketë cilësi të larta etiko-morale.

2. Agjent në seksionet e Policisë Gjyqësore mund të caktohet shtetasi që plotëson kushtet e mëposhtme:

- a) të plotësojë kriterin e arsimit, sipas ligjit për forcën policore ku bën pjesë;
- b) të ketë, të paktën, 2 vjet përvojë në profesion;
- c) të mos ketë masë disiplinore apo të mos ketë filluar ndaj tij ecuria disiplinore;
- ç) të mos jetë i dënuar me një vendim të formës së prerë, apo të mos ketë filluar ndaj tij një procedim penal;
- d) të ketë cilësi të larta etiko-morale.”.

Neni 12

Pas nenit 10 shtohet neni 10/a me këtë përmbajtje:

“Neni 10/a Caktimi në seksion

1. Caktimi në seksionet e Policisë Gjyqësore bëhet bazuar në një procedurë konkurrimi, nga ministri, që ka në kompetencë forcën policore, ku bën pjesë kandidati, ose nga Prokurori i Përgjithshëm, në rastin e juristëve dhe specialistëve të fushave të ndryshme të ekspertizës.

2. Rregulla më të hollësishme përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Prokurorit të Përgjithshëm, Ministrisë së Brendshme dhe ministrave përgjegjës, që kanë në kompetencë forca policore.”.

Neni 13

Neni 11 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 11 Transferimi dhe ngritja në detyrë e oficerëve dhe agjentëve të Policisë Gjyqësore të seksioneve

1. Organi kompetent i forcës policore njofton dhjetë ditë përpara drejtuesin e prokurorisë pranë gjykatës së rrethit gjyqësor në rastet kur do të ngrihen në përgjegjësi ose do të transferohen oficerët e Policisë Gjyqësore në varësi të tyre.

2. Nëse transferimi i oficerit të Policisë Gjyqësore mund të ndikojë në ecurinë e hetimeve paraprake të një çështjeje komplekse, transferimi shtyhet/pezullohet deri në përfundimin e hetimeve, me kërkesë të Prokurorit të Përgjithshëm, bazuar në njoftimin e drejtuesit të prokurorisë përkatëse.

3. Transferimi, qoftë edhe i përkohshëm, i oficerëve dhe agjentëve të seksioneve të Policisë Gjyqësore bëhet sipas kërkesës së motivuar të organit kompetent të forcës policore, pasi të ketë marrë mendimin paraprak dhe pëlqimin e Prokurorit të Përgjithshëm. Kundërshtimi i Prokurorit të Përgjithshëm duhet të jetë i motivuar dhe nuk mund të bëhet në rastet e ngritjes në detyrë, në nivel ose gradë të oficerëve dhe agjentëve të Policisë Gjyqësore.”.

Neni 14

Pas nenit 11 shtohen nenet 11/a dhe 11/b me këtë përmbajtje:

“Neni 11/a
Zëvendësimi

1. Oficeri i Policisë Gjyqësore ka për detyrë të heqë dorë kur ekzistojnë arsye njëanësie në ushtrimin e funksionit në një procedim të caktuar, sipas Kodit të Procedurës Penale. Mbi deklarinin e heqjes dorë vendos drejtuesi i prokurorisë, i cili, në vendimin e pranimit, e zëvendëson atë me një oficer tjetër.

2. Prokurori i çështjes kërkon zëvendësimin e oficerit të Policisë Gjyqësore, kur ekzistojnë arsye serioze që lidhen me detyrën, si dhe në rastet e parashikuara në nenet 16 dhe 17 paragrafi i parë, shkronjat “a”, “b”, “ç”, “d” dhe “dh” të Kodit të Procedurës Penale.

3. Drejtuesi i prokurorisë urdhëron zëvendësimin e oficerit të Policisë Gjyqësore, kryesisht ose me kërkesë të palëve, në rastet e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni dhe në rastet kur konstaton zvarritje të pajustificueshme të hetimeve, si dhe kur miraton kërkesën e justifikuar të oficerit të Policisë Gjyqësore për zëvendësimin.”.

Neni 11/b
Shkarkimi dhe lirimi

1. Oficeri/agjenti i Policisë Gjyqësore lirohet nga detyra kur:

a) jep dorëheqjen;
b) mbush moshën e pensionit;
c) bëhet i paaftë përgjithmonë për të kryer detyrat zyrtare, për shkak të kushteve shëndetësore;

ç) dënohet me vendim gjyqësor të formës të prerë për kryerjen e një vepre penale.

2. Oficeri/agjenti i Policisë Gjyqësore shkarkohet nga detyra kur:

a) dënohet me vendim gjyqësor të formës të prerë për kryerjen e një vepre penale;
b) merret ndaj tij masa disiplinore e largimit nga detyra.”.

Neni 15

Neni 12/a ndryshohet si më poshtë:

“Neni 12/a
**Paga dhe përfitimet e oficerëve të Policisë Gjyqësore të emëruar
nga Prokurori i Përgjithshëm**

1. Paga e oficerit të Policisë Gjyqësore, të seksioneve të prokurorive të rretheve gjyqësore dhe të prokurorive të apelit është e barabartë me 70 për qind të pagës së prokurorit të prokurorisë së rrethit gjyqësor. Pas 5 vjetësh në shërbim në seksionin e Policisë Gjyqësore, për çdo vit vjetërsi, kjo pagë, deri në 25 vjet shërbim, shtohet me 2 për qind në vit.

2. Mbi këtë pagë, për kushte të veçanta pune, paga e oficerit të Policisë Gjyqësore, të seksionit të Prokurorisë për Krime të Rënda dhe të Prokurorisë së Apelit për Krime të Rënda, si dhe të Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm shtohet 20 për qind.

3. Oficerët e Policisë Gjyqësore, të emëruar nga Prokurori i Përgjithshëm, mund të përfitojnë shpërblime, për merita profesionale, në masën e caktuar, me propozimin e drejtuesit dhe me miratimin e Prokurorit të Përgjithshëm. Kriteret për shpërblim për merita të veçanta për oficerët e Policisë Gjyqësore, të emëruar nga Prokurori i Përgjithshëm, përcaktohen me udhëzim të Prokurorit të Përgjithshëm, pasi të ketë marrë mendimin e Këshillit të Prokurorisë.

4. Oficerët e Policisë Gjyqësore, të emëruar nga Prokurori i Përgjithshëm, përfitojnë leje të pagueshme vjetore prej 30 ditësh kalendarike. Leja vjetore, si rregull, kryhet në muajin gusht. Oficeri/agjenti i Policisë Gjyqësore, i ngarkuar me kryerjen e detyrave të ngutshme në muajin gusht, lejen vjetore e kryen në një periudhë tjetër, duke përfituar pesë ditë shtesë. Për nevoja të kualifikimeve dhe specializimeve profesionale, oficeri/agjenti i Policisë Gjyqësore ka të drejtë të kërkojë leje të papagueshme dhe ruajtjen e vendit të punës deri në një vit.

5. Oficerët e Policisë Gjyqësore, të emëruar nga Prokurori i Përgjithshëm, përfitojnë për vështirësi pune një shtesë deri në 20 për qind. Kriteret për përcaktimin e vështirësive, gjatë kryerjes së punës së oficerit të Policisë Gjyqësore, miratohen me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm, me propozim të Këshillit të Prokurorisë.”.

Neni 16

Pas kreut III shtohet kreu III/1 me këtë përmbajtje:

“KREU III/1 TRAJNIMI DHE VLERËSIMI I REZULTATEVE NË PUNË

Neni 12/b

Trajnimi vazhdues i oficerëve dhe agjentëve të Policisë Gjyqësore

1. Oficerët dhe agjentët e Policisë Gjyqësore i nënshtrohen trajnimit vazhdues nga institucionet publike arsimore, të ngarkuara me ligj për trajnim.
2. Periudha e formimit vazhdues duhet të jetë në përputhje me programet e institucioneve publike, arsimore, të ngarkuara për trajnimet.
3. Pjesëmarrja në këto trajnime është e detyrueshme.
4. Rregulla më të hollësishme për organizimin e trajnimit, hartimin e programeve të trajnimit, pjesëmarrjen në to, si dhe për shpenzimet e trajnimeve përcaktohen me marrëveshje midis Prokurorit të Përgjithshëm, ministrit, që ka në kompetencë forcën policore dhe titullarit të institucionit publik arsimor.

Neni 12/c

Vlerësimi i rezultateve individuale

1. Oficerët dhe agjentët e Policisë Gjyqësore i nënshtrohen një vlerësimi individual periodik dhe një vlerësimi në rastet e ngritjes në detyrë.
2. Çdo vit drejtuesi i prokurorisë së rrethit paraqet një vlerësim të rezultateve të punës së oficerëve dhe agjentëve të Policisë Gjyqësore. Vlerësimet janë: “I paaftë”, “Mjaftueshëm”, “Mirë”, “Shumë mirë” dhe “Shkëlqyer”.
3. Vlerësimi “I paaftë” përbën shkak për fillimin e procedurës disiplinore për shkarkimin nga detyra të oficerit apo agjentit të Policisë Gjyqësore.
4. Drejtuesi i prokurorisë jep mendim për rezultatet e ushtrimit të funksioneve edhe në rast të ngritjes në detyrë, në nivel ose gradë të oficerëve dhe agjentëve të Policisë Gjyqësore të seksioneve ose shërbimeve.
5. Aktet e vlerësimit të plotësuar në zbatim të këtij neni, bëhen pjesë e dosjes personale të oficerit ose të agjentit të Policisë Gjyqësore.
6. Rregulla të hollësishme për mënyrën e vlerësimit të rezultateve individuale në punë të oficerëve dhe agjentëve të Policisë Gjyqësore, përcaktohen nga Prokurori i Përgjithshëm, pasi është marrë mendimi i ministrave, që kanë në varësi shërbim të Policisë Gjyqësore.”.

Neni 17

Pas nenit 13 shtohet neni 13/a me këtë përmbajtje:

“Neni 13/a **Fusha e zbatimit të rregullave të procedimit disiplinor**

Rregullat e këtij kreu kanë përparësi dhe zbatohen ndaj punonjësve të Policisë Gjyqësore, pavarësisht rregullimeve normative të tjera në fuqi, nëse punonjësi kryen shkelje disiplinore, sipas këtij ligji, gjatë ushtrimit të funksionit të Policisë Gjyqësore.”.

Neni 18

Neni 14 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 14

Përgjegjësia disiplinore e oficerëve dhe agjentëve të Policisë Gjyqësore

Punonjësi i Policisë Gjyqësore, gjatë ushtrimit të funksioneve të Policisë Gjyqësore, i nënshtrohet përgjegjësisë disiplinore në rastet dhe me garancitë e parashikuara në këtë ligj.”.

Neni 19

Pas nenit 14 shtohet neni 14/a me këtë përmbajtje:

“Neni 14/a

Shkeljet disiplinore

1. Shkeljet e disiplinës së punonjësit të Policisë Gjyqësore ndahen në:
 - a) të lehta;
 - b) të rënda;
 - c) shumë të rënda.
2. Janë shkelje të lehta këto akte dhe sjellje:
 - a) veprimet dhe mosveprimet e punonjësve të Policisë Gjyqësore, të cilat passjellin zvarritje të proceseve hetimore;
 - b) mungesa e pajustificuar në punë deri në 3 ditë;
 - c) akte dhe sjellje të tjera, që diskreditojnë pozitën dhe figurën e punonjësit të Policisë Gjyqësore.
3. Janë shkelje të rënda këto akte dhe sjellje:
 - a) zvarritja e pajustificuar dhe e përsëritur e veprimeve të punonjësve të Policisë Gjyqësore gjatë ushtrimit të funksioneve të parashikuara me ligj;
 - b) braktisja e punës ose mungesa e pajustificuar dhe e vijueshme për më shumë se 3 ditë;
 - c) thyerja e disiplinës në punë, në mënyrë të përsëritur dhe pas paralajmërimit të dhënë me shkrim nga eprori;
 - ç) mosinformimi i prokurorit për ecurinë e hetimeve nga oficeri drejtues, që ka për detyrë të informojë kryesisht.
4. Janë shkelje shumë të rënda aktet e poshtëshënuara:
 - a) raportimi i të dhënave për hetimin jashtë zyrës së prokurorit;
 - b) paraqitja e të dhënave dhe akteve që lidhen me kryerjen e një vepre penale, në tejkallim të afateve dhe procedurave të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale;
 - c) moskryerja, kryerja me vonesë ose ekzekutimi i pjesshëm i një urdhri të ligjshëm të gjykatës a prokurorit, që lidhet me ushtrimin e funksioneve të Policisë Gjyqësore;
 - ç) kryerja e veprimeve dhe mosveprimeve të tjera në kundërshtim me dispozitat urdhëruese apo ndaluese të Kodit të Procedurës Penale, me pasoja për hetimin e çështjes.”.

Neni 20

Neni 15 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 15

Procedimi disiplinor

1. Procedimi disiplinor fillon brenda 6 muajve nga zbulimi i shkeljes, por jo më vonë se tre vjet nga kryerja e shkeljes.

2. Procedimi disiplinor ndaj punonjësit të Policisë Gjyqësore fillon nga drejtuesi i prokurorisë ose prokurori kompetent për çështjen ku është kryer shkelja disiplinore, ose me kërkesë me shkrim drejtuar atij nga çdo organ ose person i interesuar. Kur procedimi fillon me kërkesë të organit apo personit të interesuar, kërkesa i njoftohet Prokurorit të Përgjithshëm dhe ministrit, që ka në kompetencë forcën policore.

3. Punonjësi i Policisë Gjyqësore, ndaj të cilit ka filluar procedimi disiplinor, njoftohet me shkrim për shkaqet, faktet dhe dispozitat e shkelura, për të cilat procedohet me masë disiplinore, si dhe për datën e zhvillimit të procedimit disiplinor.

4. Punonjësi i Policisë Gjyqësore, ndaj të cilit ka filluar procedimi disiplinor, ka të drejtë:

a) të informohet në mënyrë të qartë dhe të detajuar për faktet, shkeljet dhe sanksionet që mund të vendosen;

b) të formulojë pretendime dhe kërkesa;

c) të njihet me dokumentet e procedimit disiplinor dhe të depozitojë prova të mjaftueshme;

ç) të ketë asistencën e një avokati ose kolegu gjatë procedimit dhe të dëgjohet në prani të tij;

d) të kërkojë thirrjen dhe dëgjimin e dëshmitarëve, si dhe të paraqesë dokumente të tjera në mbrojtje të tij.

5. Për shqyrtimin e procedimit disiplinor ndaj punonjësit të Policisë Gjyqësore ngrihet një komision disiplinor. Komisioni kryesohet nga një prokuror i prokurorisë kompetente për çështjen ku është kryer shkelja disiplinore dhe ka në përbërje një punonjës të shërbimit të Policisë Gjyqësore dhe një punonjës të seksionit të Policisë Gjyqësore. Anëtarët e komisionit caktohen për një afat njëvjeçar, përkatësisht nga drejtuesi i prokurorisë, nga drejtuesi i seksionit dhe drejtuesi i shërbimit. Drejtuesit përkatës caktojnë edhe anëtarin zëvendësues, në rast të pamundësisë së pjesëmarrjes në komision të anëtarit të caktuar.

6. Pas shqyrtimit të fakteve dhe provave, komisioni, me shumicë votash, vendos t'i propozojë titullarit të emërtesës, i cili pranon ose refuzon kërkesën për dhënien e masës disiplinore në mënyrë të arsyetuar. Vendimi i titullarit është përfundimtar.

7. Titullari, gjatë shqyrtimit administrativ të vendimit të komisionit, mund të vendosë pezullimin nga ushtrimi i funksioneve të Policisë Gjyqësore të punonjësit të proceduar.

8. Vendimi i pezullimit në ushtrimin e funksioneve dhe vendimi përfundimtar i marrjes së masës disiplinore ekzekutohen menjëherë nga drejtuesi përkatës, në varësinë strukturore të të cilit është punonjësi i proceduar.

9. Rregulla më të detajuara për veprimtarinë e komisionit disiplinor caktohen me udhëzim të përbashkët të Prokurorit të Përgjithshëm, të Ministrit të Brendshëm pasi është marrë mendimi i ministrave, që kanë në varësi shërbim të Policisë Gjyqësore.”.

Neni 21

Pas nenit 15 shtohen nenet 15/a dhe 15/b me këtë përmbajtje:

“Neni 15/a

Masat disiplinore

1. Masat disiplinore kundër punonjësit të Policisë Gjyqësore, që jepen sipas rëndësisë dhe në raport me shkeljen disiplinore të kryer, janë si më poshtë:

a) vërejtje me shkrim;

b) vërejtje me paralajmërim;

c) ulje në detyrë me afat nga tre muaj gjer në një vit;

ç) pezullim nga detyra deri në 6 muaj;

d) largim nga detyra.

2. Për shkeljet e lehta, të parashikuara nga neni 14/a i këtij ligji, jepet masa disiplinore e parashikuar në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 1 të këtij neni.

3. Për shkeljet e rënda, të parashikuara nga neni 14/a i këtij ligji, jepet masa disiplinore e parashikuar në shkronjën “c” të pikës 1 të këtij neni.

4. Për shkeljet shumë të rënda, të parashikuara nga neni 14/a i këtij ligji, jepet masa disiplinore e parashikuar nga shkronjat “ç” e “d” të pikës 1 të këtij neni.

5. Kur punonjësi i Policisë Gjyqësore merr cilësinë e të pandehurit, ai pezullohet nga ushtrimi i detyrës deri kur gjykata të japë vendim të formës së prerë.

6. Masat disiplinore të parashikuara në këtë nen shlyhen kur kanë kaluar:

a) 1 vit nga data që është dhënë masa, sipas shkronjave “a” dhe “b” të pikës 1 të këtij neni;

b) 3 vjet nga data që ka përfunduar masa e dhënë sipas shkronjave “c” dhe “ç” të pikës 1 të këtij neni.

7. Masat disiplinore të shlyera hiqen nga dosja vetjake.

Neni 15/b

Ankimi

Vendimi përfundimtar për masën disiplinore mund të ankimohet në gjykatë nga punonjësi, ndaj të cilit është marrë masa ose nga prokurori që ka kërkuar fillimin e procedimit disiplinor.”.

Neni 22

Në nenin 16 pika 2, fjala “rolin” zëvendësohet me fjalën “nivelin”.

Neni 23

Në fund të nenit 17 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Ngarkohen Prokurori i Përgjithshëm dhe Ministri i Brendshëm që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrin aktet nënligjore përkatëse.”.

Neni 24

Fillimi i efekteve financiare të ligjit

Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i nenit 12/a të këtij ligji, fillojnë nga data 1 janar 2011.

Neni 25

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6651, datë 26.7.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

VENDIM
Nr.609, datë 8.7.2010

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.607, DATË 11.6.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË
PUNONJËSVE ME ARSIM TË LARTË TË ADMINISTRATËS GJYQËSORE TË GJYKATAVE
TË SHKALLËS SË PARË DHE TË GJYKATAVE TË APELIT, DHE TË PUNONJËSVE ME
ARSIM TË LARTË TË ADMINISTRATËS SË PROKURORIVE PRANË GJYKATAVE TË
SHKALLËS SË PARË DHE PRANË GJYKATAVE TË APELIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2 dhe 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar dhe të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.607, datë 11.6.2009 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 2, lidhja nr.1 “Struktura dhe nivelet e pagave të punonjësve me arsim të lartë të administratës gjyqësore në gjykatat e shkallës së parë dhe në gjykatat e apelit, dhe të administratës së prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë dhe pranë gjykatave të apelit”, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Paga e grupit (kolona 1) e lidhjes nr.1 është sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

c) Pika 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:

““Specialistët”, në institucionet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, që punojnë në pozicione që lidhen me procesin e informatizimit të veprimtarisë së administratës gjyqësore e të veprimtarisë së administratës së prokurorive pranë gjykatave, dhe që kërkojnë në mënyrë të detyrueshme Diplomë të Nivelit të Dytë (DND) ose Diplomë të Integruar të Nivelit të Dytë (DIND) apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në degët “Inxhinieri elektronike” apo “Informatikë”, përfitojnë një shtesë për “kushte pune”, prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh, mbi pagën mujore të kategorisë përkatëse.

Miratimi i kësaj shtese do të bëhet, rast pas rasti, nga Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor dhe nga Prokuroria e Përgjithshme, në përputhje të plotë me përshkrimin e pozicionit të punës.”.

2. Efektet financiare për paga e sigurime shoqërore, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, do të përballohen nga fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit për rritjen e pagave, për vitin 2010.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË PUNONJËSVE ME ARSIM TË LARTË
TË ADMINISTRATËS GJYQËSORE NË GJYKATAT E SHKALLËS SË PARË DHE NË
GJYKATAT E APELIT, DHE TË ADMINISTRATËS SË PROKURORIVE PRANË
GJYKATAVE TË SHKALLËS SË PARË DHE PRANË GJYKATAVE TË APELIT**

PAGA MUJORE					
POZICIONI	KATEGORIA	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHTESA E POZICIONIT
		1	2	3	4
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)
Përgjegjës i Shërbimeve Mbështetëse në Gjykatën e Krimeve të Rënda	III-a	1	2%		71 000
Kryesekretar gjyqësor Kryesekretar në prokurori Kryetar dege	III-b	1 ose 2	2%		54 000
Sekretar gjyqësor Sekretar pranë prokurorëve Specialist	IV-a	1 ose 2 ose 3	2%		43 000
Specialist	IV-b	1 ose 2 ose 3	2%		33 000

Vlera e pagës së grupit për grupet e diplomave të arsimit universitar

Grupi i diplomës	Lloji i diplomës	Vlera
1	Diplomë e Nivelit të Dytë (DND). Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë (DIND). Të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë.	12 000
2	Diplomë e Nivelit të Parë (DNP) apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë + Master i Nivelit të Parë (MNP)	11 000
3	Diplomë e Nivelit të Parë (DNP). Të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë.	10 000

**VENDIM
Nr.610, datë 8.7.2010**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.475, DATË 13.7.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË
NËPUNËSVE CIVILË, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE, NË
KRYEMINISTRI, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS, ADMINISTRATËS SË
PRESIDENTIT, KUVENDIT DHE KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës” dhe të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.475, datë 13.7.2007, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

a) Lidhja nr.1, që përmendet në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Paga e grupit (kolona 2) e lidhjes nr.1, është sipas lidhjes nr.5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

c) Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. “Specialistët”, “Përgjegjësit e sektorit” apo “Drejtorët” në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, Administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Prokurorinë e Përgjithshme dhe Gjykatën e Lartë, të cilët punojnë në pozicione që lidhen me procesin e informatizimit të administratës publike dhe kërkojnë në mënyrë të detyrueshme Diplomë të Nivelit të Dytë (DND) ose Diplomë të Integruar të Nivelit të Dytë (DIND) apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në degët “Inxhinieri elektronike” apo “Informatikë”, përfitojnë një shtesë për “kushte pune”, 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë, mbi pagën mujore të kategorisë përkatëse. Zbatimi i kësaj shtese, për pozicionet konkrete, bëhet pas miratimit paraprak të Departamentit të Administratës Publike dhe Ministrisë së Financave, sipas përshkrimit të pozicionit të punës.”.

ç) Pas pikës 6/2 shtohet pika 6/3, me këtë përmbajtje:

“6/3. Specialistët e suportit funksional në Drejtorinë e Administrimit të Sistemit të Thesarit, në Ministrinë e Financave, përfitojnë një shtesë, për “kushte pune” në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj, mbi pagën mujore të kategorisë përkatëse.”.

d) Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“9. Struktura dhe nivelet e pagave për zëvendësministrin dhe nëpunësit e kabineteve në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, Administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Prokurorisë së Përgjithshme dhe Gjykatës së Lartë përcaktohen si më poshtë:

- Zëvendësministri 136 000 lekë

- Drejtori i kabinetit të Kryeministrit, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Kryetarit të Gjykatës së Lartë barazohen në pagë me nëpunësin civil të kategorisë I-a;

- Këshilltari i Kryeministrit, shefi i protokollit të Kryeministrit, dhe drejtori i kabinetit të zëvendëskryeministrit barazohen në pagë me zëvendësministrin;

- Këshilltari i Prokurorit të Përgjithshëm, këshilltari i kryetarit të Gjykatës së Lartë, ndihmësi i Kryeministrit dhe këshilltari i zëvendëskryeministrit barazohen në pagë me nëpunësin civil të kategorisë I-b;

- Ndihmësi i zëvendëskryeministrit dhe drejtori i kabinetit të ministrit barazohen në pagë me nëpunësin civil të kategorisë II-a;

- Këshilltari i ministrit dhe zëdhënësi barazohen në pagë me nëpunësin civil të kategorisë II-b;

- Ndihmësi ligjor pranë prokurorëve në Prokurorinë e Përgjithshme dhe ekspertët në Prokurorinë e Përgjithshme barazohen në pagë me nëpunësin civil të kategorisë III-a;

- Sekretar i Kryeministrit, Presidentit, Kryetarit të Kuvendit,

Kryetarit të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm,

Zëvendëskryeministrit, nënkryetarit të Kuvendit

66 000 lekë

- Sekretar i ministrit, sekretar, sekretar i këshilltarit

të Presidentit

55 000 lekë.

Shtesa për vjetërsi në punë për pozicionet “Sekretar i Kryeministrit”, “Sekretar i Presidentit”, “Sekretar i Kryetarit të Kuvendit”, “Sekretar i zëvendëskryeministrit”, “Sekretar i nënkryetarit të Kuvendit”, “Sekretar i ministrit”, “Sekretar” dhe “Sekretar i këshilltarit të Presidentit”, jepet në masën 2 për qind pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi vlerën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë.

Të drejtën për të pasur këshilltarë të jashtëm e kanë vetëm Kryeministri dhe zëvendëskryeministri. Pagesa e tyre mujore është deri në 40 për qind të pagës mujore të këshilltarit të brendshëm. Masa e pagesës përcaktohet nga titullari i institucionit përkatës.

Këto nivele pagash zbatohen edhe për funksionet ekuivalente të administratës së Presidentit, Kuvendit dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.”.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2010, të përballohen nga fondet e politikës së pagave të miratuara për vitin 2010.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

PAGA MUJORE					
KLASA	KATEGORITË	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHTESA E POZICIONIT
		1	2	3	4
		Paga e grupit (PG) lekë	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV) në përqindje	Shtesa për kualifikim (SHK) lekë	Shtesa e pozicionit (SHP) lekë
I	I-a	1	2%		126 000
	I-b	1	2%		115 000
II	II-a	1	2%		105 000
	II-b	1	2%		88 000
III	III-a	1	2%		71 000
	III-a/1	1	2%		62 000
	III-b	1 ose 2	2%		54 000
IV	IV-a	1 ose 2 ose 3	2%		43 000
	IV-b	1 ose 2 ose 3	2%		33 000

Lidhja nr.5

VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT
UNIVERSITAR

Grupi i diplomës	Lloji i diplomës	Vlera
1	Diplomë e Nivelit të Dytë (DND). Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë (DIND). Të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë.	12 000 lekë
2	Diplomë e Nivelit të Parë (DNP) apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë + Master i Nivelit të Parë (MNP)	11 000 lekë
3	Diplomë e Nivelit të Parë (DNP). Të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë.	10 000 lekë

VENDIM
Nr.611, datë 8.7.2010

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.881, DATË 20.12.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR FUNKSIONET DREJTUESE DHE PËR STRUKTURËN NIVELET E PAGAVE NË MINISTRINË E PUNËVE TË JASHTME”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, të nenit 45 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.881, datë 20.12.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Lidhja nr.1, që përmendet në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Pas pikës 1/1 shtohet pika 1/2, me këtë përmbajtje:

“1/2. Paga e grupit (kolona 2) e lidhjes nr.1, është sipas lidhjes nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2010, të përballohen nga fondet e politikës së pagave të planifikuara për vitin 2010.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

PAGA MUJORE					
POZICIONI DREJTUES	GRADA DIPLOMATIKE	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHTESA PËR GRADË
	1	2	3	4	5
		Paga e grupit (PG) lekë	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK) lekë	Shtesa për pozicion (SHP) lekë
Sekretar i Përgjithshëm	Ambasador	1	2%		115 000
Drejtor i Përgjithshëm	Ministër fuqplotë. Ministër këshilltar. Konsull i Përgjithshëm	1	2%		105 000
Drejtor	Këshilltar	1	2%		88 000
Përgjegjës sektori	Sekretar i Parë. Konsull.	1	2%		71 000
	Sekretar i Dytë. Zëvendëskonsull.	1 ose 2	2%		54 000
	Sekretar i Tretë. Agjent Konsullor.	1 ose 2 ose 3	2%		43 000
	Atashe	1 ose 2 ose 3	2%		33 000

**VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT
UNIVERSITAR**

Grupi i diplomës	Lloji i diplomës	Vlera
1	Diplomë e Nivelit të Dytë (DND). Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë (DIND). Të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë.	12 000 lekë
2	Diplomë e Nivelit të Parë (DNP) apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë + Master i Nivelit të Parë (MNP)	11 000 lekë
3	Diplomë e Nivelit të Parë (DNP). Të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë.	10 000 lekë

**VENDIM
Nr.612, datë 8.7.2010**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.561, DATË 16.8.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PAGAT SIPAS GRADAVE PËR PUNONJËSIT, OFICERË DHE
NËNOFICERË, TË GARDËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.561, datë 16.8.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

Në pikën 1, lidhja nr.1 “Niveli i pagës për gradë, sipas roleve për punonjësit e Gardës së Republikës”, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit për rritjen e pagave për vitin 2010.

3. Ngarkohet Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2010.

**KRYEMINISTRI
Sali Berisha**

**NIVELI I PAGËS PËR GRADË SIPAS ROLEVE PËR PUNONJËSIT E GARDËS SË
REPUBLIKËS**

Roli i punonjësve sipas gradave	Grada	Paga bazë për gradë	
Për punonjësit oficerë	Madhor	Gjeneral garde	107 000
	I lartë	Kolonel	93 000
		N/kolonel	82 000
		Major	70 000
	I mesëm	Kapiten	59 500
		N/kapiten	56 500
	I ulët	Toger	53 500
		N/toger	50 500
Për punonjësit nënoficerë	Madhor	Kryekapter	42 500
	I lartë	Kapter	40 500
		Kapter shtabi	39 500
		Kapter mjeshtër	38 500
	I mesëm	Kapter i parë	38 000
		Kapter i dytë	37 500
		Kapter i tretë	37 000
	I ulët	Kapter i katërt	36 300
		Rreshter	35 200

**VENDIM
Nr.613, datë 8.7.2010**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.371, DATË 14.6.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË
NËPUNËSVE TË DISA INSTITUCIONEVE NË VARËSI TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE/KRYEMINISTRIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.371, datë 14.6.2006, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:
 - a) Lidhja nr.1, që përmendet në pikën 2, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 - b) Lidhja nr.1/1, që përmendet në pikën 2/1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 - c) Lidhja nr.2, që përmendet në pikën 3, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 - ç) Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Paga e grupit (kolona 1) e lidhjeve nr.1 e nr.2 është sipas lidhjes nr.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.
 - d) paragrafi i dytë i pikës 8, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Specialistët”, “Përgjegjësit e sektorit” apo “Drejtorët”, në institucionet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, që punojnë në pozicione pune që lidhen me procesin e informatizimit të administratës publike dhe kërkojnë në mënyrë të detyrueshme Diplomë të Nivelit të Dytë (DND) ose Diplomë të Integruar të Nivelit të Dytë (DIND) apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në degët “Inxhinieri elektronike” apo “Informatikë”, përfitojnë një shtesë për “kushte pune”, prej 10 000 (dhjetë mijë) lekë, mbi pagën mujore të kategorisë përkatëse. Zbatimi i kësaj shtese, për pozicionet konkrete, bëhet pas miratimit paraprak të Departamentit të Administratës Publike dhe Ministrisë së Financave, sipas përshkrimit të pozicionit të punës. Përfshihen nga ky parashikim nëpunësit e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.”.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2010, të përballohen nga fondet e politikës së pagave të miratuara për vitin 2010.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE NË INSTITUCIONET QENDRORE NË VARËSI TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE/KRYEMINISTRIT

PAGA MUJORE					
POZICIONI	KATEGORIA	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHTESA E POZICIONIT
		1	2	3	4
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)
Titullar i institucionit	II-a	1	2%		105 000
Zv/titullar i institucionit. Drejtor drejtorie. Anëtar i Komisionit të Prokurimit Publik.	II-b	1	2%		88 000
Anëtar i organit drejtues. Inspektor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të arkivave.	III-a	1	2%		71 000
Përgjegjës sektori. Përgjegjës i Bibliotekës Shkencore në Akademinë e Shkencave.	III-a/1	1	2%		62 000
Përgjegjës sektori. Kryetar Dege në Akademinë e Shkencave	III-b	1	2%		54 000
Inspektor. Redaktor në Akademinë e Shkencave.	III-b	1 ose 2	2%		54 000
Asistent seksioni në Akademinë e Shkencave. Bibliografe në Akademinë e Shkencave	IV-a	1 ose 2 ose 3	2%		43 000
Specialist	IV-a	1 ose 2 ose 3	2%		43 000
	IV-b	1 ose 2 ose 3	2%		33 000

**STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE NË AGJENCINË
KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË INFORMACIONIT**

POZICIONI	KATEGORIA	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHTESA E POZICIONIT	SHTESA PËR KUSHTE PUNE
		1	2	3	4	
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	
Titullar i institucionit	II-a	1	2%		105 000	20 000
Zv/titullar i institucionit. Drejtor drejtorie në Drejtoritë e Përmbajtjes	II-b	1	2%		88 000	15 000
Drejtor Drejtorie në Drejtoritë Mbështetëse	II-b	1	2%		88 000	0
Përgjegjës sektori në sektorët e përmbajtjes	III-a/1	1	2%		62 000	20 000
Përgjegjës Sektori në Sektorët Mbështetës	III-a/1	1	2%		62 000	0
	III-b	1	2%		54 000	0
Specialist në Sektorët apo Drejtoritë e Përmbajtjes.	III-b	1 ose 2	2%		54 000	25 000
Specialist në sektorët apo drejtoritë mbështetëse	IV-a	1 ose 2 ose 3	2%		43 000	0
	IV-b	1 ose 2 ose 3	2%		33 000	0

Lidhja nr.2

**STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE TË INSTITUCIONEVE
RAJONALE/VENDORE NË VARËSI TË INSTITUCIONEVE QENDRORE NË VARËSI TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE/KRYEMINISTRIT**

PAGA MUJORE					
POZICIONI	KATEGORIA	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHTESA E POZICIONIT
		1	2	3	4
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)
Titullar i institucionit rajonal.	III-b	1	2%		54 000
Titullar i institucionit vendor. Përgjegjës sektori në institucionet rajonale	IV-a	1	2%		43 000
Përgjegjës sektori i institucionit vendor.	IV-b	1	2%		33 000
Specialist në institucionet rajonale	IV-b	1 ose 2 ose 3	2%		33 000
Specialist në institucionet vendore	IV-c	1 ose 2 ose 3	2%		25 000

**VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT
UNIVERSITAR**

Grupi i diplomës	Lloji i diplomës	Vlera
1	Diplomë e Nivelit të Dytë (DND). Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë (DIND). Të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë.	12 000 lekë
2	Diplomë e Nivelit të Parë (DNP) apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë + Master i Nivelit të Parë (MNP)	11 000 lekë
3	Diplomë e Nivelit të Parë (DNP). Të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë.	10 000 lekë

**VENDIM
Nr.614, datë 8.7.2010**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.370, DATË 14.6.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË
NËPUNËSVE TË ADMINISTRATËS SË PREFEKTIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.370, datë 14.6.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon;

“1. Nivelet e pagave për funksionet e mëposhtme të jenë:

a) Prefekt i qarkut Tiranë	115 000 lekë;
b) Prefekt i qarqeve të tjera	107 000 lekë;
c) Nënprefekt i nënprefekturave Kavajë, Lushnjë dhe Sarandë	92 000 lekë;
ç) Nënprefekt i nënprefekturave Krujë, Pogradec, Librazhd, Tepelenë, Përmet, Mat, Pukë, Tropojë dhe Skrapar	85 000 lekë;
d) Nënprefekt i nënprefekturave Malësi e Madhe, Bulqizë, Peqin, Gramsh, Devoll, Mallakastër, Has, Kuçovë, Mirditë, Delvinë, Kurbin dhe Kolonjë	81 100 lekë;
dh) Këshilltar i prefektit, Tiranë	64 000 lekë;
e) Zëdhënës i prefektit, Tiranë	54 000 lekë.”.
2. Lidhja nr.1, që përmendet në pikën 2, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Paga e grupit (kolona 1) e lidhjes nr.1 është sipas lidhjes nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.
4. Pika 6.1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6/1. “Specialistët”, “Përgjegjësit e zyrës”, apo “Përgjegjësit e sektorit”, në prefektura dhe nënprefektura, që punojnë në pozicione pune që lidhen me procesin e informatizimit të administratës publike dhe kërkojnë në mënyrë të detyrueshme Diplomë të Nivelit të Dytë (DND) ose Diplomë të

Integruar të Nivelit të Dytë (DIND) apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në degët “Inxhinieri elektronike” apo “Informatikë”, përfitojnë një shtesë për “kushte pune”, prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh, mbi pagën mujore të kategorisë përkatëse. Zbatimi i kësaj shtese, për pozicionet konkrete, bëhet pas miratimit paraprak të Departamentit të Administratës Publike dhe Ministrisë së Financave, sipas përshkrimit të pozicionit të punës.”.

3. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2010, të përballohen nga fondet e politikës së pagave të miratuara për vitin 2010.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

PAGA MUJORE					
EMËRTIMI	KATEGORIA	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHTESA E POZICIONIT
		1	2	3	4
		Paga e grupit (PG) lekë	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV) përqindje	Shtesa për kualifikim (SHK) lekë	Shtesa e pozicionit (SHP) lekë
Sekretar i Përgjithshëm në prefekturë	III-a	1	2%		71 000
Sekretar i Përgjithshëm në nënprefekturat Kavajë, Lushnjë dhe Sarandë	III-a/1	1	2%		62 000
Përgjegjës sektori në prefekturë	III-b	1	2%		54 000
	IV-a	1	2%		43 000
Përgjegjës zyre në prefekturë	IV-a	1	2%		43 000
Përgjegjës zyre në nënprefekturë	IV-a	1	2%		43 000
Përgjegjës sektori në nënprefekturë	IV-a	1	2%		43 000
Inspektor auditit në prefekturë	IV-a	1 ose 2	2%		43 000
Specialist në prefekturë	IV-b	1 ose 2 ose 3	2%		33 000
	IV-c	1 ose 2 ose 3	2%		25 000
Specialist në nënprefekturë	IV-c	1 ose 2 ose 3	2%		25 000
Sekretar	IV-c	1 ose 2 ose 3	2%		25 000

Lidhja nr.3

VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT
UNIVERSITAR

Grupi i diplomës	Lloji i diplomës	Vlera
1	Diplomë e Nivelit të Dytë (DND) Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë (DIND) Të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë	12 000 lekë
2	Diplomë e Nivelit të Parë (DNP) apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë + Master i Nivelit të Parë (MNP)	11 000 lekë
3	Diplomë e Nivelit të Parë (DNP). Të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë	10 000 lekë

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 24.8.2010

Doli nga shtypi më 24.8.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 24 lekë